



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 96

2003

Nëntor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.758, datë 13.11.2003	Për pilotimin e shpërndarjes së fondeve të ndihmës ekonomike, të kushtëzuar me punë dhe shërbime në komunitet.....	4187
Vendim i KM nr.764, datë 13.11.2003	Për miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për njohjen e ndërsjellë të dokumenteve të arsimit dhe të gradave shkencore.....	4188
Vendim i KM nr.771, datë 13.11.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë.....	4191

VENDIM
Nr.758, datë 13.11.2003

PËR PILOTIMIN E SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË KUSHTËZUAR ME PUNË DHE SHËRBIME NË KOMUNITET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 37 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", të shkronjës "c" të pikës 6 të nenit 72 të ligjit nr.8652, datë 31.5.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të pilotojë shpërndarjen e blloknndihmës ekonomike, në fillim të vitit ose për një periudhë 4-mujore për njësitë e qeverisjes vendore.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, që do të zbatojnë programe punësimi dhe shërbimesh me fondet e blloknndihmës ekonomike, fondet e veta ose donacionet e ndryshme, do të përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, sipas kriterëve ligjore.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, që pilotimin e shpërndarjes së ndihmës ekonomike e kushtëzojnë me punë a shërbime në komunitet, të raportojnë në zyrën rajonale ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror për:

- a) përshkrimin e gjendjes social-ekonomike për periudhën pararendëse;
- b) kategorizimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike;
- c) numrin e familjeve dhe të anëtarëve të aftë për punë, të cilët mund të punojnë a kryejnë shërbime në komunitet;
- ç) numrin e familjeve, të anëtarëve me aftësi të kufizuar dhe të atyre mbi moshë pune, të cilët nuk kanë mundësi për të punuar a kryer shërbime në komunitet;
- d) projektet e punësimit a të shërbimit, të miratuara nga këshilli bashkiak/komunal, ndërmarrjet dhe sipërmarrësit që do të zbatojnë projektin.

4. Programimi i fondeve për njësitë në pilotim bazohet në treguesit social-ekonomikë për periudhën e mëparshme, të vërtetuar nga institucionet përkatëse, duke u mbështetur në strukturën dhe në të ardhurat e familjes.

5. Bashkia/komuna ka të drejtë të përdorë për punë dhe shërbime në komunitet të gjitha fondet e kursyera nga ulja e numrit të familjeve që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, si rezultat i përfshirjes së tyre në projekte punësimi a shërbimi, sipas këtij vendimi.

6. Këshilli bashkiak/komunal përcakton kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të familjes që do të marrin pjesë në punë ose shërbime në komunitet, miraton projektet dhe njësinë zbatuese të projektit.

7. Anëtarët e familjeve të përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 3 janë kontigjent për plotësimin e nevojave për punë a shërbime në komunitet.

8. Si njësi zbatuese të projekteve, përveç ndërmarrjeve apo sektorëve në varësi të bashkisë/komunës, kanë të drejtë të aplikojnë për financim, zbatim dhe bashkëfinancim projektsh edhe personat juridikë e OJF-të.

9. Projektet miratohen nga këshilli bashkiak/komunal dhe nuk prekin fondet e nevojshme për familjet e përcaktuara në shkronjën "ç" të pikës 3. Këshilli bashkiak/komunal njofton Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit për projektet e miratuara.

10. Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, me udhëzim të përbashkët, përcaktojnë mënyrën e monitorimit dhe të kontrollit financiar.

11. Familja, anëtari i së cilës është i aftë për punë, por nuk pranon punësimin nëpërmjet programeve të punëve a shërbimeve në komunitet, e humbet të drejtën e përfitimit të ndihmës ekonomike.

12. Masa e pagesës së personave pjesëmarrës në projektet për punë ose shërbime në komunitet nuk duhet të jetë më i ulët se niveli 100 për qind i pagës minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë ndryshon kjo e fundit.

13. Në koston e projektit përfshihen edhe shpenzimet për të mbuluar koston e kontributeve të punëdhënësit për sigurimet shoqërore dhe sigurimin shëndetësor.

14. Masa e pagesës së personave pjesëmarrës në projekte, për punë a shërbime me kohë të pjesshme, të jetë sa masa maksimale e ndihmës ekonomike.

15. Periudha e pjesëmarrjes në punë a shërbime në komunitet ka të njëjtën kohëzgjatje me projektin. Pas mbarimit të projektit, familja ka të drejtë të riaplikojë për përfitim nga skema e ndihmës ekonomike, duke respektuar kriteret e legjislacionit në fuqi për përfitimin e ndihmës.

16. Fondet për financimin e projekteve, që kursehen gjatë procesit të realizimit të punëve a shërbimeve në komunitet, nuk mund të përdoren jashtë destinacionit të tyre.

17. Bashkia/komuna raporton, çdo muaj, në zyrën rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për ecurinë e projektit.

18. Bashkia/komuna njofton zyrën e punësimit të rrethit ku zbatohet projekti, për të punësuarit sipas këtij programi.

19. Fondet e ndihmës ekonomike, që përdoren për zbatimin e projekteve për punë a shërbime në komunitet, nuk i nënshtrohen ligjit "Për prokurimin publik" dhe përjashtohen nga TVSH-ja. Pjesa tjetër e fondeve që paracaktohen për zbatimin e projektit u nënshtrohen kriterëve të përcaktuara në ligjin "Për prokurimin publik" dhe udhëzimeve në fuqi.

20. Bashkitë/komunat, në kontratën që lidhin me zbatuesit e projektit, duhet të respektojnë kriteret e përcaktuara nga këshilli bashkiak/komunal.

21. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për nxjerrjen e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.764, datë 13.11.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR NJOHJEN E NDËRSJELLË TË DOKUMENTEVE TË ARSIMIT DHE TË GRADAVE SHKENCORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për njohjen e ndërsjellë të dokumenteve të arsimit dhe të gradave shkencore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

MARRËVESHJE

NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR NJOHJEN RECIPROKE TË DOKUMENTEVE TË ARSIMIT DHE GRADAVE SHKENCORE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, më poshtë të

quajtura Palë:

- *me synimin për të inkurajuar* zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit dhe të shkencës;

- *me synimin për të lehtësuar* lëvizjen e potencialeve intelektuale të të dy vendeve, ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Kjo Marrëveshje ndërqeveritare përcakton procedurat për njohjen reciproke të dokumenteve të arsimit dhe të gradave shkencore, të lëshuara nga institucionet arsimore dhe organet kompetente, të krijuara dhe të njohura në përputhje me legjislacionin në fuqi në të dy vendet.

Neni 2

Njohja e dokumenteve të arsimit dhe e gradave shkencore realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit përkatës.

Neni 3

Njohja reciproke e dokumenteve, përmendur në nenin 1, nuk mund të realizohet në rast të ndryshimeve thelbësore në përmbajtjen dhe kërkesat ekzistuese për përfitim të dokumenteve arsimore dhe të gradave shkencore në Republikën e Shqipërisë dhe të shkallëve arsimore e shkencore në Republikën e Bullgarisë.

Neni 4

Dokumentet për klasën e përfunduar, për arsimin e përfunduar tetëvjeçar dhe të mesëm, të përgjithshëm dhe profesional, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, dhe dokumentet për klasën e përfunduar, për arsimin e përfunduar tetëvjeçar, të mesëm dhe profesional, të lëshuara në Republikën e Bullgarisë, konsiderohen të të njëjtit nivel nga të dyja Palët.

Neni 5

Dokumentet e arsimit të mesëm, të përgjithshëm dhe profesional, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, dhe dokumentet e arsimit të mesëm dhe profesional, të lëshuara në Republikën e Bullgarisë, që lejojnë vazhdimin e arsimit të lartë në vendin përkatës, i japin zotëruesve të tyre të drejtën e aplikimit në shkollat e larta, në territorin e vendit tjetër.

Neni 6

Dokumentet e arsimit profesional, të lëshuara nga shkollat e mesme profesionale në Republikën e Shqipërisë, dhe dokumentet e kualifikimit profesional, të lëshuara nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Bullgarisë, për profesione të njëjta ose të ngjashme, konsiderohen të vlefshme në territorin e vendit tjetër.

Neni 7

Diplomat e arsimit të lartë jouniversitar, me kohëzgjatje 3-3.5 vjet, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, dhe diplomat e arsimit të lartë profesional të shkallës arsimore e kualifikuese "Specialist për...", me kohëzgjatje minimale 3 vjet, të lëshuara në Republikën e Bullgarisë, në fusha të njëjta ose të ngjashme studimi, konsiderohen të të njëjtit nivel arsimimi nga të dyja Palët dhe u japin të drejtën zotëruesve të tyre të vazhdojnë studimet e mëtejshme në përputhje me legjislacionin e secilit vend.

Neni 8

Diplomat e arsimit të lartë, të lëshuara nga shkollat e larta në Republikën e Shqipërisë, me një kohëzgjatje të paktën katër vjet, dhe diplomat e arsimit të lartë të shkallës arsimore e kualifikuese "*bachelor*", të lëshuara nga shkollat e larta në Republikën e Bullgarisë, me një kohëzgjatje të paktën katër vjet, në fusha të njëjta ose të ngjashme studimi, konsiderohen të të njëjtit nivel arsimimi nga të dyja Palët dhe u japin të drejtën zotëruesve të tyre të vazhdojnë studimet e mëtejshme, në përputhje me legjislacionin e secilit vend.

Neni 9

Diplomat e gradës shkencore "Doktor i shkencave", të lëshuara në Republikën e Shqipërisë dhe diplomat e shkallës arsimore e shkencore "Doktor", të lëshuara në Republikën e Bullgarisë, konsiderohen të të njëjtit nivel nga të dyja Palët.

Neni 10

Dokumentet e lëshuara nga shkollat e larta, që vërtetojnë përfundimin e studimeve me një kohëzgjatje më pak se një vit, në fusha të njëjta ose të ngjashme studimi, pas përfundimit të arsimit të lartë, konsiderohen të vlefshme në territorin e të dy vendeve.

Neni 11

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, të dyja Palët janë të detyruara të mbajnë njëra-tjetrën të informuara mbi kriteret dhe procedurat për njohjen e dokumenteve arsimore dhe të gradave shkencore, si edhe mbi ndryshimet e mundshme të sistemeve arsimore dhe të procedurave për lëshimin e gradave shkencore.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e marrjes së notës së dytë me anën e së cilës, në rrugë diplomatike, Palët janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën për zbatimin e kërkesave të legjislacionit kombëtar për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Kjo Marrëveshje është me afat të pakufizuar.

Secila nga këto Palë mund të anulojë këtë Marrëveshje. Në këtë rast, Marrëveshja pushon së ekzistuari një vit pas marrjes së notës me anën e së cilës, në rrugë diplomatike, Palët njoftojnë njëra-tjetrën për anulimin e Marrëveshjes.

Neni 14

Në rast anulimi të kësaj Marrëveshjeje, nenet e saj do të mbeten në fuqi për qytetarët e Republikës së Shqipërisë dhe për qytetarët e Republikës së Bullgarisë, të cilët kanë filluar studimet para anulimit të kësaj Marrëveshjeje nga njëra prej Palëve.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua në Tiranë në datën 26.3.2003, në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht. Secili variant ka vlerë të barabartë. Në rast mosmarrëveshesh në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të merret parasysh vetëm varianti anglisht.

VENDIM
Nr.771, datë 13.11.2003

PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDËTËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 dhe 82 pika 1 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të neneve 4, 5 e 24 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 28 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fazat e transferimit të mbledhjes së kontributeve në organet tatimore

Pagesa e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor, nga personat juridikë e fizikë, të kalojë nga llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në llogaritë e caktuara për arkëtimin e tyre, në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të organeve në varësi të saj, sipas këtyre fazave:

a) Tatimpaguesit me qendër në Tiranë, të regjistruar në degën e tatimpaguesve të mëdhenj, duke filluar nga data 1 nëntor 2003.

b) Tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", duke filluar nga data 1 maj 2004.

c) Institucionet buxhetore, duke filluar nga data 1 gusht 2004.

ç) Tatimpaguesit e regjistruar në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin", duke filluar nga data 1 prill 2005.

Pagesa e kontributeve sipas fazave të mësipërme përfshin detyrimet për kontributet, të llogaritura në bazë të listëpagesave të muajve pararendës.

2. Transferimi i kontributeve

Për arkëtimin e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të interesave të lidhura me to, organet tatimore hapin pranë bankave të nivelit të dytë llogari të veçanta për sigurimin shoqëror dhe për sigurimin shëndetësor.

Gjendja e këtyre llogarive, në fund të çdo dite pune të kalohet në llogaritë e përcaktuara të organeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor. Procedurat teknike për transferimin e shumave të arkëtuara nga një llogari bankare në tjetrën, përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, instituteve përkatëse dhe bankave të nivelit të dytë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj, në asnjë rast, nuk mund të prekin gjendjen e llogarive për arkëtimin e kontributeve.

Gjjobat e vëna në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" nuk trajtohen si kontribute, dhe si të tilla ato ritransferohen në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht, në llogaritë tremujore të organeve tatimore me kërkesën e këtyre të fundit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës dhe derdhen në Buxhetin e Shtetit, si çdo gjobë tjetër tatimore. Procedurat e identifikimit të shumave të arkëtuara nga gjjobat vendosen me marrëveshje ndërmjet palëve.

3. Shkëmbimi i të dhënave

Organet tatimore dërgojnë në organet e sigurimeve shoqërore, në organet e sigurimeve shëndetësore dhe në Institutin e Statistikave (INSTAT) të dhënat e mëposhtme:

3.1 Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore:

a) Listëpagesat origjinale, sipas formatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të ligjit.

b) Të dhënat e përpunuara për kontributet, përfitimet dhe interesat e paguara nga çdo subjekt dhe për çdo kontributpagues në format elektronik. Të dhënat për çdo kontributpagues jepen muajin e parë që pason muajin, në të cilin Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka pajisur kontributpaguesit me

numrin e sigurimeve shoqërore.

c) Të dhënat për kontributet, përfitimet dhe interesat në muajin vijues pas muajit në të cilin është paraqitur deklarata.

ç) Të dhënat për çdo kontributpagues individual, çdo tremujor, në muajin vijues pas muajit në të cilin është marrë listëpagesa, duke filluar me tremujorin, në të cilin Instituti i Sigurimeve Shoqërore i ka pajisur kontributpaguesit me numrin e sigurimeve shoqërore.

d) Të dhënat mujore për detyrimet për kontributet e paguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët, për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur.

dh) Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarive që ushtrojnë.

3.2. Për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor:

a) Të dhënat e përpunuara për kontributet dhe interesat e paguara nga çdo subjekt dhe për çdo kontributpagues në format elektronik. Këto të dhëna për çdo kontributpagues jepen muajin e parë, që pason muajin në të cilin Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka pajisur kontributpaguesit me numrin e sigurimeve shoqërore.

b) Të dhënat për kontributet në muajin vijues pas muajit në të cilin është paraqitur deklarata.

c) Të dhënat për çdo kontributpagues individual, çdo tremujor, në muajin vijues pas muajit në të cilin është marrë listëpagesa, duke filluar me tremujorin në të cilin Instituti i Sigurimeve Shoqërore i ka pajisur kontributpaguesit me numrin e sigurimeve shoqërore.

ç) Të dhënat mujore për detyrimet për kontributet e paguara në afat për çdo subjekt, si dhe për kreditorët, për kontribute të paguara më tepër se detyrimi i llogaritur.

3.3 Për Institutin e Statistikave (INSTAT):

- Të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarisë që ushtrojnë.

- Përmbajtja e të dhënave është e përcaktuar në shtojcën "A", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe dërgohet në institucionet përkatëse, çdo tremujor, jo më vonë se fundi i muajit që vijon pas muajit të deklarimit.

- Në rastet kur të dhënat nuk zotërohen për shkak të mosdorëzimit të deklaratave nga tatimpaguesit, organet tatimore do t'ua paraqesin të dhënat instituteve, jo më vonë se fundi i muajit që vijon pas muajit të marrjes së deklaratës dhe pagesës.

4. Paga bruto për efekt të llogaritjes së kontributeve

Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune, dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës.

Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nuk përfshihen:

a) përfitimet që punëmarrësi merr, në mënyrë të përhershme, nga fondet e sigurimeve shoqërore;

b) kompensimet nga rritja e çmimeve;

c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;

ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykatë;

d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë për personat e punësuar sipas legjislacionit në fuqi;

dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë për rastet e fatkeqësive, për sëmundjet e gjata, për dëme në raste fatkeqësish të mëdha natyrore e për veprimtari të shquara;

e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit;

ë) honoraret apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet e punës

5. Programimi i të ardhurave nga kontributet

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas fazave të transferimit të shërbimit, për subjektet ku mbledhja e kontributeve kalon në organet tatimore, është përgjegjëse për realizimin e planit të të ardhurave. Për periudhën tranzitore, plani vjetor i të ardhurave nga kontributet ndahet ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

Hartimi i planit të të ardhurave nga kontributet e detyrueshme të sigurimit shoqëror dhe shëndetësor realizohet nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas metodologjisë, procedurave dhe afateve të përcaktuara në ligjet përkatëse.

6. Mbledhja e detyrimeve të prapambetura

Vjelja e detyrimeve të prapambetura për subjektet aktive, mbledhja e kontributeve të të cilave kalon në organet tatimore, realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj. Të dhënat që duhet të japë Instituti i Sigurimeve Shoqërore për organet tatimore, për këtë qëllim, përcaktohen në marrëveshjen ndërmjet të të dyja palëve.

7. Dhënia e numrit të sigurimeve shoqërore

Instituti i Sigurimeve Shoqërore merr masa për dhënien e numrit të identifikimit për çdo kontributpagues.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Shtojca A

Forma dhe përmbajtja e të dhënave që do t'u jepen ISSH, ISKSH dhe INSTAT

1. Kontributet e paguara sipas deklaramit për çdo punëmarrës dhe të vetëpunësuar:

- Numri i sigurimeve shoqërore (NI Kombëtar)*

- Emri i punëmarrësit*

- Paga për qëllimet e kontributeve

- Kontributet e punëdhënësit

- Kontributet e punëmarrësit

- Kontributet shtesë

- Kontributet bruto

- Përfitimet gjithsej të paguara

- Kontributet neto*

- Data e fillimit

- Data e largimit

- Kontributet shëndetësore*

- Periudha tatimore*

- NIPT-i i punëdhënësit*

- Kodi NACE i punëdhënësit*

- Kategoria e punëmarrësit

(Për tatimpaguesit e vetëpunësuar raportohen vetëm të dhënat e shënuara me *)

2. Përfitimet e paguara për çdo punëmarrës sipas deklaramit:

- Numri i sigurimeve shoqërore

- Kodi i përfitimit

- Shuma

- Ditë

- Periudha tatimore (vvvv/mm)

3. Të dhënat e pagesës për tatimpaguesit e regjistruar

- NIPT-i

- Shuma e arkëtuar në llogarinë e organit tatimor për kontributet e sigurimeve shoqërore

- Shuma e arkëtuar në llogarinë e organit tatimor për kontributet e sigurimeve shëndetësore.

- Shuma e arkëtuar në llogarinë e organit tatimor për interesat mbi pagesat e vonuara të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

- Shuma e arkëtuar në llogarinë e organit tatimor për interesat mbi pagesat e vonuara të kontributeve të sigurimeve shëndetësore

- Periudha tatimore e pagesës.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 27.11.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 100 lekë